




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Komiteti Konsultativ për mbrojtje të Ambientit Zhvillim
Ekonomik, shëndetesi dhe Mirëqenie sociale



Nr. 12.052-35 05 dt. 21.01 2020

RAPORT I KONSTITUIMIT

2019

Drenas 2020

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Takimi I parë.....	4
Takimi I dytë.....	5
Takimi I tretë.....	6
Konkludime.....	7

Hyrje

Procedura e themelimit, organizimi dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna është dhënë nga Udhëzimi Administrativ I Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me Nr.01/2016.

Qëllimi I këtij udhëzimi administrative është që përmes komiteteve konsultative në komuna të krijoj mundësinë për pjesmarrjen aktive të qytetarëve dhe grupev tjera të interes, në procesin e vendimmarrjes për interes public.

Komitetet konsultative janë trupa ndihmës të kuvendit të komunës, roli I të cilave është që përmes këtyre komiteteve të jenë më transparente, më efikase dhe të japin më shumë llogari qytetarëve.

Në komën e Drenasit aktualisht veprojnë katër Komitete konsultative.

Komiteti Konsultativ për zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është formuar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Drenasit të mbajtur me 26.09.2019.

Me këtë vendim po ashtu është aprovuar edhe lista e anëtarëve të këtij komiteti në përbërje prej pesë (5) anëtarëve si vijon:

1. Fitore Sefiu-Shabani
2. Burim Dvorani
3. Arbresha Haziri
4. Violeta Ipshi-Bujupi
5. Basri Gashani

Mandati I komitetit konsultativ nga themelimi dhe aprovimi në Kuvend eshte katër (4) vjeqar

ORGANIZIMI I PUNËS

Takimi I parë

Mbledhja e parë e Komiteti Konsultativ për zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është mbajtur me 09.10.2019.

Temat e trajtuara ishin: Zgjedha e kryesuesit të Komitetit, Zgjedhja e zëvendës kryesuesit si dhe diskutimi rreth Udhëzimit Administrativ, funksionimit dhe kompetencave të Komiteteve Konsultative.

Kryesues I Komiteti Konsultativ për zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është zgjedhur Fitore Sefiu-Shabani, ndërsa zëvendës kryesues është zgjedhur Burim Dvorani.



Fig.1. Përbërja e komitetit

Takimi I dytë

Takimi I dytë është mbajtur me 26.11.2019. Në këtë takim kemi shqyrtuar një kërkesë të banorëve të komunës së Drenasit më konkretisht të objektit banesorë "Altrade Holding" e cila gjendet në rrugën Bedri Shala. Sic thuhet nga banorët në hyrje të ndërtesës janë vendosur dy kontenjer të mbeturinave të cilat bëjnë pengse për banorët në hyrje-dalje të ndërtesës si dhe nga kundërmimet e mbeturinave. Problemi në fjalë është drejtuar drejtorisë përkatëse përkatësisht Drejtorisë për Emergjencë.

Po ashtu takuam edhe me drejtoreshën për Zhvillim Ekonomik me znj. Egzona Jetullahu.

Takimi ishte më tepër një takim njoftues duke shqyrtuar edhe mundësitë e bashkepunimit në të ardhmen.

Takimi I tretë

Mbledhja e tretë e Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik ,Mbrotje të Ambientit , Shëndetesi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS) , u mbajt më 06.12.2019.

Ndër të tjerat që u diskutuan ishin edhe takimi me drejtoreshën e Shërbimeve Publike dhe Emergjencia znj.Lumnije Krapu. Në këtë takim u konsultuam për problemet e qytetarëve të komunës së Drenasit në fushat të ndryshme si me ujë të pijshëm, ndotje të ambientit nga qytetarët e pandërgjegjshëm nga mbeturinat dhe ujrat e zeza.




Fig.2.takimi me drejtoreshën znj.Lumnije Krapu

Poashtu takuam edhe kryesuesin e Kuvendit Komunal të Drenasit z.Labinot Halilaj.Takimi me z.Halilaj ishte një takim formal njohës si dhe informues rreth Kuvendit.



Fig.3.Takimi me z.Labinot Halilaj

Konkludime

Megjithë faktin që ne si komitet jemi formuar në fund të vitit 2019, me përkushtimin tonë si komitet dhe me ndihmën e zyrtarëve të drejtorivë të Komunëesh së Drenasit, kemi arritur një bashkëpunim duke u munduar t'u dalim në ndihmë qytetarëve tonë.

Besojmë dhe shpresojmë se së bashku do të arrijme të jemi një urë bashkëpunuese në mes qytetarëve dhe shërbyesvë komunal.

Kryesuese KKZHE MASHMS

Fitore Sefiu-Shabani

